

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje vegla pune, Sharre Asfalti Çelesa krik etj

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Krike mekanike, sharra dore

VLERA E FONDIT LIMIT : 1,190,990 (Një milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh , vënë në dispozicion nga te ardhurat e veta

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ujësjetës Kanalizime Kamëz sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR TË DYJA LOTET

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të L.PP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2020, 2021 dhe 2022) ku vlera mesatare e tyre te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Autoriteti Kontraktor i është referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 2, gërma a) dhe vlerën e xhiros minimale vjetore e ka përcaktuar brenda kufirit maksimal të lejuar nga ky nen.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 të konfirmuara nga Organet tatimore shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar (vetëm në rastin kur janë objekt i nenshkrimit të auditimit), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti profesional dhe teknik

Kapaciteti profesional

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht 238,198(dyqind e tridhjetë e tetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kriteri i vendosur tregon që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që vlera totale e kontratave//kontratës të mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, të jetë jo më e vogël se 15 % e vlerës së përllogaritur të fondit limit për lotin / shumatoren e loteve për të cilat konkurron.

Kapaciteti teknik

2.3.2. Ditën dhe orën e hapjes së ofertave, ofertuesi duhet të dorëzojë në zyrën e prokurimeve të UKK sh.a, mostra të artikujve me nr. rendor, 3,5,13,14,19,55,57,58, sipas specifikimeve të kërkuara në dokumentat bashkelidhur SPE.

Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

Kujdes:

Mosdorëzimi i mostrave të këtyre produkteve përbën kusht s'kualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 40, pika 6, germa a, të vendimit nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Për shkak se artikujt e kërkuar do të perdoren për procesin zgjedhor, duke u shpërndarë në të gjithë territorin e vendit për të mos pasur problematika dhe pamundesë për të ndryshuar mallarat e shpërndarë për komisionet zonale është kërkuar paraprakisht dorëzimi i mostrave.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetëdeklarim garancie për artikujt e kërkuar dhe në rast shpallje fitues duhet të lëshojë Autoritetit Kontraktor fletë garanci si më poshtë vijon:

Makineri për prerje asfalti – 12 muaj

Matrapik – 12 muaj

Makine elektrovizive me ngjitje 50mm-200mm– 12 muaj

Pompe lavazhi– 12 muaj

Saldatriçe inverter Stanley Super 180 ose ekuivalente, 1 fazore, 3.2/5.3 kW, 230V, 25-160 Amp, 1.6 - 4 mm elektrodë- 12 muaj

Fresibel-12 muaj

Trapan- 12 muaj

Meter Lazer- 12 muaj

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. AK ka vlerësuar se është e nevojshme garancia për këto produkte pasi janë produkte të rëndësishme dhe të jenë në gjendje funksionale për të paktën 12 muaj.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

- **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës, është bërë nga grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit. Fondi Limit i kësaj procedure është bazuar në testimine e tregut dhe kontratat e mëparshme.

Specifikimet teknike janë vendosur nga grupi i punës duke ju referuar qëllimit për të cilin do të përdoren artikujt.